

## Thirrje për Shprehje Interesi nga Organizatat e Shoqërisë Civile për tu bërë pjesë e Grupit Kombëtar të Punës për Reformën në Administratën Publike

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, në emër të rrjetit rajonal *Think for Europe Network* (TEN) dhe në kuadër të [projektit WeBER](#), fton të gjitha Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të) në Shqipëri që janë të interesuara të përfshihen në krijimin dhe funksionimin e Grupit Kombëtar të Punës (GKP) për monitorimin e Reformës në Administratën Publike (RAP) në Ballkanin Perendimor.

Grupet Kombëtare të Punës do të shërbejnë si një mekanizma këshillues kombëtar që iu mundësojnë pjesëmarrjen organizatave të shoqërisë civile në dialogun me autoritetet publike në hartimin dhe monitorimin e procesit të Reformës në Administratën Publike në Ballkanin Perendimor. GKP do të krijohen në të gjitha vendet e Ballkanit Perendimor si pjesë e një mekanizmi më të gjerë këshillues për dialogun mbi Reformën në Administratën Publike – [Platforma WeBER](#), e themeluar në Podgoricë, në Nëntor të vitit 2016.

GKP sigurojnë që dialogu mbi Reformën në Administratën Publike të jetë gjithëpërfshirës në lidhje me shoqërinë civile, përmes pjesëmarrjes së organizatave vendore që operojnë në të dyja nivelet, në nivel qendror dhe atë vendor.

Antarësimi në GKP është i hapur për të gjitha OShC-të e interesuara. Nëse organizata juaj është e interesuar të bëhet anëtare e GKP, ju lutem dërgoni Shprehjen e Interesit, duke përfshirë një përshkrim të shkurtër të përvojës së mëparshme të organizatës në procese të Reformës në Administratën Publike. Nëse organizata juaj nuk ka qenë më parë aktive në këtë fushë, mjafton të theksoni motivin tuaj për tu angazhuar në procesin e monitorimit të RAP.

Në mënyrë që aplikimi juaj të jetë i plotë, përveç Shprehjes së Interesit, Lutemi të plotësoni pyetësorin për vlerësimin e nevojave të OShC-ve për ngritjen e kapaciteteve në fushën e PAR. Pyetësorin mund ta shkarkoni këtu: [https://www.surveymonkey.com/r/WeBER\\_NWG\\_Questionnaire\\_Albania](https://www.surveymonkey.com/r/WeBER_NWG_Questionnaire_Albania). Afati i fundit për dorëzimin e Aplikimit është 20 Mars 2017, përmes postës elektronike tek: [gevurmo@idmalbania.org](mailto:gevurmo@idmalbania.org).

Pse t'i bashkangjiteni GKP-s?

Natyra e veçantë e platformës WeBER dhe GKP, mbështetet në qasjen gjithpërfshirëse e cila përqendrohet në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe ndërtimit të partneritetit shumëpalësh me qëllim rritjen e ndikimit në monitorimin e proceseve në RAP.

Në veçanti, GKP:

- Përfshijnë organizatat lokale që shprehin interes apo janë duke monitoruar punën e institucioneve në nivel vendor;
- Krijojnë mundësi për zhvillimin e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile përmes trajnimeve, workshopeve dhe mbështetjes në zbatimin e metodologjisë për monitorimin e RAP, në nivel qendror dhe vendor;
- Krijojnë mundësi për organizatat vendore me më pak përvojë në fushën e RAP që të nisin ndërtimin e eksperiencës rreth RAP, duke i inkurajuar kështu që të propozojnë projekte [dhe aplikojnë për grante të vogla për monitorimin e reformës së administratës publike](#).

Motivi për krijimin e GKP është përfshirja e sa më shumë organizatave të shoqërisë civile në mënyrë që të krijohet një mekanizëm kombëtar i gjerë por edhe i besueshëm, i cili do përfaqësojë pikpamjet dhe qendrimit e shoqërisë civile lidhur me procesin e monitorimit të RAP. GKP rrjedhin nga logjika dhe struktura e Platformës WeBER e cila ofron një forum të përbashkët për pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile në monitorimin e RAP dhe lehtëson dialogun midis OSHC-ve dhe institucioneve publike në nivel kombëtar dhe atë rajonal. Secili partneritet në kuadër të platformës paraqet një GPK për shtetin përkatës, duke pasur gjithnjë parasysh specifikat e mjedisit në të cilin operojnë organizatat e shoqërisë civile, si dhe disponueshmëria dhe nevoja për hulumtime të bazuara në fakte si dhe advokim për RAP. Organizatat që do udhëheqin dhe koordinojnë punën e GKP (të ashtuquajtur “partneritet kombëtar”), të cilat janë njëkohësisht pjesë e Platformës Rajonale të WeBER, janë:

- Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) , Koordinator i GPK dhe WeBER për Shqipërinë;
- Lëvizja Shqiptare Europiane - Tiranë
- Instituti Axfenda - Tiranë
- Instituti Shqiptar i Shkencës – Tiranë

Anëtarët e Platformës në Shqipëri , si dhe anëtarët e shteteve të tjera<sup>1</sup> janë përzgjedhur përmes një Thirrje të Hapur për Shprehje Interesi.

Për më shumë informacion rreth funksionimit, strukturës dhe përfitimeve nga anëtarësimi në Grupin Kombëtar të Punës për Reformën në Administratën Publike, Lutemi konsultoni Draftin e

---

<sup>1</sup> Për të parë të gjithë anëtarët e projektit WeBER, ju lutem vizitoni: <http://www.par-monitor.org/pages/members>.

Konceptit të Grupit Kombëtar të Punës për Reformën në Administratën Publike<sup>2</sup>, i bashkëngjitur si Shtojcë në këtë Thirrje për Shprehje Interesi.

Qëllimi i përgjithshëm i WeBER është të nxisw pjesëmarrjen dhe ngrjw kapacitetet e organizatave të shoqërisë civile (OSHC) dhe medias në Ballkanin Përendimor (BP) për të advokuar dhe ndikuar në hartimin dhe zbatimin e Reformës së Administratës Publike (RAP). Për më shumë informata rreth projektit WeBER, Lutemi vizioni faqen zyrtare të projektit: <http://www.par-monitor.org>.

---

<sup>2</sup> Koncepti për krijimin e Grupeve Punuese Kombëtare për RAP është hartuar në kuadër të projektit tre vjeçar WeBER (Western Balkans Enabling Project for Civil Society Monitoring of Public Administration Reform - WeBER), financuar nga Bashkimi Evropian dhe bashkë-financuar nga Mbretëria e Hollandës. Për më shumë informacion, vizitoni: <http://www.par-monitor.org>